



5 Martesa në Zvicër

Qëllimi: Për personat të cilët dëshirojnë të lidhin kurorë në Zvicër me një shtetas zviceran apo me një të huaj që jeton në Zvicër me leje qëndrimi të përkohshme ose të përhershme.

Ju lutemi të mos vonoheni në ditën e takimit. Nëse arrini me vonesë, ju duhet të caktoni takim të ri.

Të keni parasysh se:

- **Asnjë dokument nuk duhet të dërgohet drejtpërdrejt në ambasadë.**
- **Ju duhet t'i sillni dokumentet personalisht në ditën kur ju është caktuar takimi.**
- **Dosjet e pakompletuara nuk pranohen.**

► Dokumentet e nevojshme:

- 3 formularë "Vizë D" të plotësuar dhe të nënshkruar si dhe 4 fotografi pasaporte.
- Formulari "Kërkesë për përgatitje për martesë". Ky formular duhet të plotësohet paraprakisht (pa datë, pa nënshkrim).
- Dokumenti i vlefshëm i udhëtimit si dhe 4 kopje.
- 4 kopje të pasaportës dhe të leje qëndrimit së bashkëshortit/-es në Zvicër.
- Certifikata e lindjes origjinale lëshuar nga autoriteti kompetent ku ka ndodhur lindja..
- Certifikata familjare origjinale.
- Certifikata personale origjinale.*
- Certifikata për lidhje martese origjinale, e lëshuar nga autoritetet kompetente shqiptare.
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar nga Ministria e Drejtësisë. *
- Formulari "Pyetje shtesë për bashkimin familjar" i plotësuar dhe i nënshkruar nga partneri i cili jeton në Zvicër.
- Nëse keni ndryshuar emrin: Kopje e vërtetuar e vendimit të ndryshimit të emrit lëshuar nga gjykata.*
- Nëse jeni i/e shkurorëzuar: Kopje e vërtetuar e vendimit të shkurorëzimit (me shënimin rreth plotfuqishmërisë) lëshuar nga gjykata. *
- Nëse jeni i/e ve: Dokumenti origjinal "Certifikate vdekje" i/e bashkëshortit/-es.
- Nëse keni lindur jashtë martesës: Pranimi i atësisë lëshuar nga zyra e Gjendjes Civile përkatëse.*
- Nëse keni fëmijë të përbashkët: Certifikata e lindjes origjinale.

INFORMACIONE TË RËNDËSISHME:

- Të gjitha dokumentet duhet të jenë me nga një kopje shtesë.
- * Të gjitha vendimet të cilat janë në vetëm ne gjuhen shqipe duhet të përkthehen në njërën prej gjuhëve zyrtare të Zvicrës.
- Gjithë dokumentet e gjendjes civile nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj.
- Partneri në Zvicër duhet të interesohet në Qendrën e Statusit Civil përkatës për hapat e më tutjeshëm.
- Për aplikim në Kosovë nuk është e nevojshme prania e partnerit i cili banon në Zvicër.
- Formularët merren falas në sportelin e Ambasadës Zvicerane.

Të gjitha dokumentet shqiptare duhet të jenë me vulë apostile nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.



Qendra Regjionale Konsullore për Ballkanin Perëndimor c/o Ambasada Zvicerane në Kosovë

Informacione të përgjithshme:

- Vetëm personave me takim të caktuar ju lejohet hyrja tek sporteli.
- Vendimet merren vetëm nga autoritetet e kantonit apo të shtetit federal në Zvicër.
- Për informata shtesë: www.eda.admin.ch/westbalkan

Si caktohet takimi:

- **Caktimi i takimit:** Ju lutemi të kontaktoni ambasadën tonë përmes e-mailit për të caktuar takim: pri.visa@eda.admin.ch. Ju lutemi të bashkëngjiti një kopje të skanuar dhe të lexueshme të pasaportës të secilit person që dëshiron të bëjë kërkesë për martesë në Kosovë.
- **Dorëzimi i dokumenteve :** Përmbajuni udhëzimeve në lidhje me takimin dhe siguroni të gjitha dokumentet e nevojshme. Ejani në ambasadë në ditën dhe orarin e takimit tuaj.
- **Marrja e vendimit :** Vendimi për vizë merret nga autoritetet kompetente dhe partneri në Zvicër do të informohet me shkrim. Kur merrni vendimin, ju lutemi që të paraqiteni me kopjen e vendimit dhe pasaportën tuaj prej të hënës deri të premtën prej orës 8.00 deri në orën 9:45 në Ambasadë.

Takimet caktohen në mënyre kronologjike dhe janë pa pagesë (nuk ka takime me prioritet)

Orari i punës i sektorit konsullor:

Dorëzimi i aplikimit:

vetëm me termin

e hënë - e premte

Pagesat për aplikim të vizave:

Pagesa për procedurën në Prishtinë është 203€ + 60€ tarifa e vizës.

- Për çdo pagesë që e bëni ju takon një fletëpagesë e nënshkruar.
- Pagesa duhet të bëhet në Euro.
- Pagesa bëhet vetëm tek sporteli brenda ambasadës (ndërtesa brenda rrethojave të zeza).
- Tarifat në lidhje me shërbimet konsullore janë llogaritur në bazë të rregullores RS 191.11.
- Tarifat në lidhje me aplikimet për vizë janë llogaritur në bazë të rregullores RS 142.209.
- Varësisht prej rasti: Pagesë shtesë administrative.
- Paratë e pagesës nuk rimburohen (edhe në rast se viza refuzohet).

Kuides nga Agjencitë

- Gjithë ata që ofrojnë shërbime jashtë rrethojave të zeza nuk i përkasin stafit të ambasadës.
- Ambasada Zvicerane nuk bashkëpunon me asnjë agjenci jashtë ndërtesës së vet.
- Stafi i Ambasadës Zvicerane nuk ka kontakt me agjencitë jashtë ndërtesës.
- Ambasada Zvicerane gjendet në hapësirat e kufizuara me rrethoja të zeza.
- Ambasada Zvicerane i jep formularët pa pagesë.
- Ambasada Zvicerane jep informata pa pagesë.
- Ambasada Zvicerane nuk rekomandon asnjë kompani të sigurimeve.

Kini parasysh se Ambasada Zvicerane:

- Nuk pranon aplikim në rast se nuk keni takim të caktuar.
- Nuk jep informata përmes telefonit apo emailit në lidhje me aplikimet për vizë në pritje.
- Ka të drejtë:
 - ° të kërkojë dokumente shtesë.
 - ° ti dërgojë aplikimet për vendim apo miratim tek autoritetet në Zvicër.
 - ° ti thërrasë aplikantët në bisedë ose intervistë.
 - ° ta ndryshojë këtë rregullore pa një njoftim paraprak.